

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

Spektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor

**Dështimi për t'i trajtuar në mënyrë të duhur
parashtresat e palëve gjatë procedurës civile**

Raport mujor

Dhjetor, 2009

Dështimi për t'i trajtuar në mënyrë të duhur parashtresat e palëve gjatë procedurës civile

Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë është i brengosur se dështimi i gjykatave për t'i trajtuar në mënyrë të duhur parashtresat e palëve gjatë procedurës civile¹ në gjykatat e Kosovës mund ta shkelë kornizën ligjore të Kosovës dhe të sjellë deri te shkeljet e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Në lëndët që i ka monitoruar, OSBE-ja ka vërejtur që gjykatat shpeshherë nuk ofrojnë arsyetim përkatës në aktvendimet që i nxjerrin apo, në disa raste, nuk përgjigjen fare në parashtresat e palëve gjatë procedurës. Krahas shkeljes së mundshme të kornizës ligjore të Kosovës, kjo praktikë gjithashtu mund të ndikojë negativisht në gëzimin e të drejtave të palëve që rrjedhin nga e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, të garantuar me nenin 6 të *Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut* (KEDNJ)², dhe përfshijnë, mes tjerash, të drejtën që lënda të shqyrtohet në mënyrë të drejtë, të drejtën për aktgjykim të arsyetuar, të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe të drejtën për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj.

Trajtimi në mënyrë të duhur nga ana e gjykatës i parashtresave të palëve gjatë procedurës civile është thelbësor për korrektësinë e procedurës civile kontestimore. Gjatë dëgjimit të një lënde, gjykata ka për detyrë “t'i shqyrtojë në mënyrë efikase bazat, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët.”³ Dështimi i gjykatës për t'i shqyrtuar në mënyrë të duhur argumentet “specifike, përkatëse dhe të rëndësishme”⁴ të palës është konsideruar vazhdimisht nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) të jetë shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së.⁵

Dështimi i gjykatave për t'i trajtuar në mënyrë të duhur parashtresat e palëve gjatë procedurës civile mund të ketë ndikim të pafavorshëm në të drejtën e palëve për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo e drejtë mund të shkelet nëse gjykatat i vonojnë pa arsye aktvendimet mbi

¹ Parashtresë e palës gjatë procedurës civile është kërkesa apo ankesa, e përkohshme apo kalimtare, zgjidhja e së cilës nuk përbën “zgjidhje përfundimtare të tërë kontestit.” Shih *Fjalorin e termeve juridike të Black-ut, edicioni i 8-të* (Shtetet e Bashkuara, Thomson West, 2004), faqe 832.

² *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, e miratuar në Romë më 4 nëntor 1950.

³ *Dulaurans kundër Francës*, aktgjykim i GjEDNJ-së i datës 21 mars 2000, paragrafi 33. Shih *Kraska kundër Zvicrrës*, aktgjykim i GjEDNJ-së i datës 19 prill 1993, paragrafi 30: efekti i nenit 6(1) është që ta obligojë gjykatën që “ta bëjë shqyrtimin e duhur të shkresave, argumenteve dhe provave të dhëna nga palët, pa e paragjykuar vlerësimin e saj se a janë relevante ato për vendimin e saj”. Shih gjithashtu *Van de Hurk kundër Holandës*, aktgjykim i GjEDNJ-së i datës 19 prill 1994, paragrafi 59; *Jokela kundër Finlandës*, aktgjykim i GjEDNJ-së i datës 21 maj 2002, paragrafi 68.

⁴ *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i GjEDNJ-së i datës 18 korrik 2006, paragrafi 25. Në këtë lëndë, GjEDNJ gjeti që shkelja e nenit 6 të KEDNJ-së ndodhi kur gjykata vendore nuk e morri parasysh një pikë që aplikantja e kishte ngritur në ankesën e saj, edhe pse ajo ishte “specifike, përkatëse dhe e rëndësishme”.

⁵ Përveç aktgjykimeve të lartpërmendura, shih gjithashtu: *Kuznetsov kundër Rusisë*, aktgjykim i GjEDNJ-së i datës 11 janar 2007, paragrafi 84, ku GjEDNJ gjeti që një shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së kishte ndodhur kur thelbi i ankesave të aplikantëve ishte lënë jashtë shqyrtimit nga ana e gjykatave vendore, të cilat refuzuan t'i shqyrtojnë meritat e ankesës të tyre; si dhe *De Moor kundër Belgjikës*, aktgjykim i GjEDNJ-së i datës 23 qershor 1994, paragrafi 55, ku gjykata vendosi që kërkesat për gjykim të drejtë nuk ishin përbushur në rastin kur Këshilli i Avokatëve në Belgjikë e refuzoi aplikacionin e aplikantit pa i shqyrtuar kriteret relevante ligjore.

parashtrerasat e palëve gjatë procedurës apo nxjerrin aktvendime të paarsyetuara që mund të përbëjnë shkelje të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008.⁶

Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008 e themelon një kornizë normative për zhvillimin e procedurës civile në mënyrë të parashikueshme dhe të shpejtë. Ligji thekson në veçanti që shkelja thelbësore e procedurës kontestimore ekziston gjithmonë nëse aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet. Të metat ekzistojnë, mes tjerash, “nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit.”⁷ Kërkesa që aktvendimet e gjykatës që merren gjatë procedurës të jenë të arsyetuara në mënyrë të duhur nënkuptohet nga kërkesa e ligjit që aktgjykimet e formës së prerë të jenë të arsyetuara në mënyrë të duhur.⁸ Për më tepër, dispozitat e caktuara të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008 që kanë të bëjnë me aktgjykimet e formës së prerë janë gjithashtu të zbatueshme edhe për vendimet/aktvendimet që nxirren gjatë procedurës.⁹ Shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore, ku mund të bëjë pjesë dështimi për të ofruar aktvendim të arsyetuar në mënyrë të duhur, paraqet shkak për ta goditur aktgjykimin.¹⁰

⁶ Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, Gazeta zyrtare e Kosovës, 20 shtator 2008 (Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008), që gjykatat e Kosovës filluan ta zbatojnë më 6 tetor 2008. Shih gjithashtu Gazetën zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë 4/1977, 36/1980 dhe 66/1982 (12 shkurt 1982) (me ndryshimet e vitit 1998) (Ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 1982). Shumë dispozita të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008 mbesin të ngjashme në masë të madhe me ato të Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982. Siç është shtjelluar më poshtë, shkeljet e tilla të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008 mund të paraqesin shkak për ta goditur aktgjykimin. Nëse kjo ndodh, palët duhet ta presin rezultatin e rigjykimit për një përcaktim të së drejtave dhe obligimeve civile që do të ishte bërë më herët po që se gjykata do ta kishte respektuar procedurën e duhur. Shih *König kundër FRG*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 qershor 1978, paragrafi 99 (sjellja e autoriteteve kompetente administrative dhe gjyqësore është një faktor që duhet të merret në konsideratë gjatë përcaktimit të asaj se sa ka qenë e arsyeshme kohëzgjatja së procedurës civile).

⁷ Neni 182.2 (n) i Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008. Shih gjithashtu pikën 13 të paragrafit 2 të nenit 354 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982, që vendos një kërkesë të ngjashme.

⁸ Neni 160 i Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008 i përcakton kërkesat për aktgjykim me shkrim. Këto kërkesa përbëhen, në një pjesë, nga arsyetimi si për rezultatin përfundimtar ashtu edhe për aktvendimet që gjykata i ka dhënë gjatë procedurës e që kanë ndikim në rezultatin përfundimtar. Neni 160.4 thotë “Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.” Neni 160.5 thotë “Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor”

⁹ Shih nenin 175 të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008.

¹⁰ Shih nenin 181.1 (a) të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008. Aktgjykimi gjithashtu mund të goditet: “(b) për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike; [ose] (c) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.” Neni 181.1.

Aktgjykimi i arsyetuar është një përbërës tjetër kyç i gjykimit të drejtë dhe është esencial për ta mundësuar shqyrtimin publik të ndarjes së drejtësisë.¹¹ Aktgjykimet e arsyetuara u tregojnë palëve që ato janë dëgjuar dhe ua ofrojnë mundësinë të ankohen kundër aktgjykimeve apo që aktvendimi të rishqyrtohet nga një organ ankimi.¹² Nga gjykatat nuk kërkohet të japin “përgjigje të hollësishme për secilin argument”¹³ dhe ato gëzojnë “një liri të caktuar të vendosjes për t’i zgjedhur argumentet në një rast të veçantë dhe për t’i marrë provat që mbështesin parashtrirat e palëve.”¹⁴ Megjithatë, pavarësisht kësaj, e drejta lëndore e GjEDNj-së i obligon autoritetet që t’i arsyetojnë veprimet e tyre duke i ofruar arsyet për vendimet e tyre,¹⁵ dhe ky obligim përfshin, në veçanti, kërkesën që gjykatat t’i ofrojnë arsyet për aktgjykimet e tyre.¹⁶

Përkundër kërkesës së qartë të ligjit që gjykata të përgjigjen në mënyrë të duhur në parashtrirat e palëve gjatë procedurës, OSBE-ja ka monitoruar lëndë në të cilat gjykatat nuk ofruan kurrfarë arsytimi në aktvendimet e dhëna më herët gjatë procedurës, madje as në aktgjykimin e formës së prerë.¹⁷ Rastet në vijim shërbejnë si shembuj.

Më 5 shtator 2008, në një lëndë për kompensim të dëmit para një gjykate në rajonin e Prishtinës/Priština, kryetari i gjykatës komunale nxori një aktvendim me të cilin e refuzoi kërkesën e të paditurit për përjashtim të kryetarit të kolegjit. Në aktvendim thuhej shkurtimisht që kryetari i kolegjit kishte vepruar “në pajtim me ligjin” dhe që “asnjë nga veprimet procedurale të kryetarit të kolegjit nuk mund të konsideroheshin si të paligjshme”. Aty nuk u përmendën cilat veprime i kishte kundërshtuar i padituri, si dhe nuk u cekën kurrfarë referencash ndaj ndonjë dispozite ligjore në të cilat ishte bazuar aktvendimi. Deri në tetor të vitit 2009, lënda ishte ende në pritje të ekspertizës për ta vlerësuar dëmin e shkaktuar ndaj paditësit.

Aktvendimet për përjashtim të gjyqtarit nga procedura civile kontestimore do të duhej që gjithmonë të kenë arsytim. Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008 i rendit kriteret specifike kur një gjyqtar mund të përjashtohet.¹⁸ Gjykata do të duhej që gjithmonë t’i referohet zbatueshmërisë së këtyre kriterëve kur të nxjerrë aktvendim mbi kërkesën e palës për përjashtim të gjyqtarit.

¹¹ *Tatishvili kundër Rusisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 9 korrik, paragrafi 58. Shih, *me ndryshimet përkatëse*, *Hirvisaari kundër Finlandës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 27 shtator 2001, paragrafi 30.

¹² *Suominen kundër Finlandës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 1 korrik 2003, paragrafi 37.

¹³ *Pronina kundër Ukrainës*, më lart në fusnotën 4, paragrafi 23.

¹⁴ *Tatishvili kundër Rusisë*, më lart në fusnotën 11, paragrafi 58. *Suominen kundër Finlandës*, më lart në fusnotën 12, paragrafi 36. “Se çfarë janë përmasat e zbatueshmërisë së këtij obligimi për t’i ofruar arsyet mund të dallojë në pajtim me natyrën e aktvendimit. Për më tepër, është e nevojshme që të merret në konsideratë, mes tjerash, shumëllojshmëria e parashtrirave që një palë ndërgjyqëse mund t’i parashtrrojë para gjykatave dhe [...] dallimet [...] në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, mendimin ligjor dhe prezantimin dhe hartimin e aktgjykimeve.” *Hiro Balani kundër Spanjës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 9 dhjetor 1994, paragrafi 27.

¹⁵ *Tatishvili kundër Rusisë*, më lart në fusnotën 11, paragrafi 58.

¹⁶ *Pronina kundër Ukrainës*, më lart në fusnotën 4, paragrafi 23.

¹⁷ Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008 kërkon qartë që aktgjykimi i formës së prerë duhet të përmbajë arsyetimin e aktvendimeve të gjykatës të dhëna më herët gjatë procedurës e që kanë ndikim në rezultatin e saj. Shih nenet 160.4 dhe 160.5, të cituara më lart në fusnotën 8.

¹⁸ Shih nenin 67 të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008. Shih gjithashtu dispozitën e ngjashme dhe analoge në nenin 71 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982.

Kërkesa për përjashtim të gjyqtarit është vetëm një lloj i parashtresave që palët mund ta parashtrorjnë gjatë procedurës civile kontestimore. Një lloj tjetër i parashtresave gjatë procedurës është kërkesa për marrje të provave.¹⁹ OSBE-ja ka vërejtur që gjykatat shpeshherë nuk ofrojnë arsyetim të mjaftueshëm në aktvendimet e tyre për t'i pranuar apo refuzuar kërkesat për marrje të provave. Rasti më poshtë shërben si një shembull tjetër i dështimit të gjykatës për të nxjerrë aktvendim të arsyetuar në mënyrë të duhur.

Më 3 shtator 2009, gjatë seancës përgatitore në një lëndë në lidhje me ndryshimin e vendimit për kujdestarinë e fëmijës në një gjykatë në rajonin e Prizrenit, përfaqësuesit e secilës palë kërkuan të merren prova të ndryshme. Të njëjtën ditë, pas shqyrtimit të vet, kolegji gjykues nxori aktvendimin ku thuhej që kërkesat e të dy palëve për marrje të provave ishin refuzuar. Në aktvendimin nuk ishte ofruar kurrfarë arsytimi. Më 16 shtator 2009, pas një seance dhe shqyrtimi tjetër, kolegji përsëri refuzoi të marrë provat e propozuara por kësaj here gjykata e ofroi një arsyetim me gojë. Mirëpo, ky arsyetim nuk u raportua në procesverbal, duke i privuar kështu palët nga mundësia që ta përfshijnë atë sipas fuqisë së tij në çdo parashtresë tjetër para gjykatës.²⁰

Sipas Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008, nga palët në procedurën civile kontestimore kërkohet “të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”²¹ Në anën tjetër, ligji kërkon nga gjykata “të vendosë se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, në bazë të çmuarjes më ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit,”²² dhe “të çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku.”²³ Kur pala kërkon nga gjykata që ta marrë një provë, gjykata duhet të tregojë që e ka përmbushur obligimin e saj që e përcaktojnë nenet e lartpërmendura duke nxjerrë aktvendime të arsyetuara mirë si përgjigje në atë kërkesë.

OSBE-ja gjithashtu ka monitoruar lëndë në të cilat gjykata i vonoi pa arsye përgjigjet e saj në parashtresat e palëve gjatë procedurës, apo i injoroi plotësisht parashtresat. Rastet në vijim shërbejnë si shembuj:

¹⁹ Kjo nënkupton “të ofrohet ose paraqitet për t’u marrë në konsideratë (diçka) si provë apo autoritet”. Shih *Fjalorin e termeve juridike të Black-ut, edicioni i 8-të* (Shtetet e Bashkuara, Thomson West, 2004), faqe 42. Të dy ligjet për procedurën kontestimore, si ai i vitit 1982, ashtu edhe ai i vitit 2008, ia lënë gjykatës të vendosë për provat që do t’i marrë në konsideratë për t’i shërbyer aktvendimit të saj. Shih nenet 219 dhe 220 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982, dhe nenin 319 të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008.

²⁰ Përveç kësaj, një dështim i tillë për ta shënuar arsyetimin me gojë në procesverbal mund ta shkelë nenin 135.2 të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008, që thotë: “Procesverbali duhet të përmbajë të dhëna esenciale për përmbajtjen e veprimit të kryer. Në procesverbalin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes duhet të përfshihet sidomos: nëse seanca është mbajtur me dyer të hapura apo të mbyllura, përmbajtja e deklaratave të palëve, propozimet e tyre, provat që i kanë ofruar, provat që janë shfrytëzuar, duke u treguar përmbajtja e thënieve të dëshmitarëve dhe ekspertëve, vendimet e gjykatës të marra në seancë, por edhe vendimi burimor i dhënë pas përfundimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike.”

²¹ Neni 7.1, Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008.

²² Neni 8.1, Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008.

²³ Neni 8.2, Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008.

Më 22 qershor 2007, në një gjykatë komunale në rajonin e Prishtinës/Priština, në një lëndë që kishte të bëjë me vazhdimin e urdhrin për mbrojtje, kërkuesi kërkoi përjashtim të gjyqtarit nga lënda në bazë të asaj që kryetari i kolegjit ende nuk kishte vendosur mbi lëndën dhe kërkuesi vente në pyetje objektivitetin e tij. Kërkesa iu parashtrua kryetarit të gjykatës komunale dhe në të thuhej që kërkuesi e kishte informuar me gojë paraprakisht kryetarin e gjykatës për rrethanat në të cilat ishte kërkuar përjashtimi në fjalë. Më 22 qershor 2007, gjykata komunale nxori një aktvendim me të cilin e refuzoi kërkesën për vazhdim të urdhrin për mbrojtje. Kryetari i gjykatës komunale nuk e shqyrtoi fare kërkesën për përjashtim të gjyqtarit. Më 27 qershor 2007, kërkuesi u ankua në gjykatën e qarkut. Më 13 nëntor 2007, gjykata e qarkut nxori një aktvendim me të cilin e ktheu rastin për rigjykim në gjykatën komunale, me arsyetim se ishte shkelur pika 10 e paragrafit 2 të nenit 354 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982.²⁴ Më 12 shtator 2008, në gjykatën komunale u mbajt seanca e parë e rigjykimit, që iu caktua të njëjtit kryetar të kolegjit që e kishte nxjerrë aktgjykimin e shkallës së parë.²⁵ Për shkak të mungesës së aktvendimit të kryetarit të gjykatës mbi kërkesën e kërkuesit për përjashtim të kryetarit të kolegjit, ky i fundit e shtyu seancën deri më 6 tetor 2008. Kryetari i gjykatës komunale e kishte nxjerrë, në fakt, një aktvendim më 12 shtator 2008, përmes së cilit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit si të pabazuar, pa ofruar ndonjë sqarim tjetër.²⁶

Si Ligji për procedurën kontestimore i vitit 2008, ashtu edhe ai i vitit 1982, parashohin qartas veprimet që gjykata duhet t'i ndërmarrë kur pala ta ketë parashtruar kërkesën për përjashtim të gjyqtarit nga procesi.²⁷ Gjykata nuk e ka mundësinë ta injorojë një kërkesë të tillë ose ta vonojë pafund përgjigjen në të dhe, nëse konsideron që kërkesa nuk është bërë me kohë në pajtim me ligjin, atëherë ajo duhet të nxjerrë një aktvendim ku është theksuar ky qëndrim.

Kur gjykatat nuk i trajtojnë në mënyrë të duhur kërkesat e palëve për përjashtim të gjyqtarit nga një lëndë, ato mund ta rrezikojnë të drejtën e palëve për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj. Gjykatat e shkelin të drejtën e palëve

²⁴ Sa i përket dispozitës së cituar, shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore, që ofron shkak për kundërshtimin e aktgjykimin, ekziston në qoftë se “gjykata e ka nxjerrë aktgjykimin pa shqyrtim kryesor, kurse e ka pasur për detyrë të zhvillojë shqyrtimin kryesor.” Në këtë lëndë, gjykata nuk mbajti kurrfarë shqyrtimi prej parashtrimit të kërkesës së kërkuesit më 7 maj 2007 e deri kur u vendos mbi atë kërkesë më 22 qershor 2007, përkundër kërkesave që dalin nga neni 12 dhe 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje.

²⁵ Neni 394 i Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982 lejon që lënda t'i kthehet për rigjykim të njëjtit apo tjetrit kolegjt të gjykatës së shkallës së parë. Në mënyrë të ngjashme, neni 198.3 i Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008 thotë që gjykata “mund të urdhërojë që rishqyrtimi i çështjes të bëhet nga gjyqtari tjetër”.

²⁶ Gjykata komunale pastaj mbajti seancat e rigjykimit më 6 tetor 2008 dhe 24 tetor 2008. Më 24 tetor, gjykata komunale përsëri nxori një aktgjykim me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për vazhdim të urdhrin për mbrojtje. Kërkuesi u ankua përsëri në gjykatën e qarkut. Më 6 shkurt 2009, gjykata e qarkut përsëri nxori një aktvendim me të cilin e ktheu rastin për rigjykim në gjykatë komunale, kësaj here me arsyetim se ishin shkelur dispozitat e pikës 14 të paragrafit 2 të nenit 354 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982. Lënda përsëri iu caktua kryetarit të njëjtit të kolegjit që e kishte nxjerrë aktgjykimin e shkallës së parë. Pas dy seancave të caktuara të rigjykimit të dytë në të cilat nuk mori pjesë asnjëra nga palët, gjykata nxori një aktgjykim ku thuhej që kërkesa konsiderohej të jetë tërhequr.

²⁷ Shih nenet 73 dhe 74 të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 2008. Shih gjithashtu nenet 72 deri 75 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982.

për gjykatë të pavarur kur dështojnë të ofrojnë “garanci të mjaftueshme për ta përjashtuar çfarëdo dyshimi legjitim për paanshmërinë e tyre.”²⁸ Prandaj, nëse pala kërkon përjashtimin e gjyqtarit nga procedura duke u bazuar në këtë dyshim, dështimi i gjykatës për ta hequr atë dyshim duke e shqyrtuar kërkesën me kohë mund të përbëjë shkelje të së drejtës së palës për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme.

Lënda në vijim shërben si një shembull tjetër i dështimit të gjykatës për ta trajtuar në mënyrë të duhur parashtrësën e palës gjatë procedurës.

Më 16 shtator 2009, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor në një lëndë të uzurpimit ndëretnik të pronës që u mbajt në një gjykatë në rajonin e Prizrenit, avokati i të paditurit e kundërshtoi vlerësimin e dëmit që e kishte dhënë një ekspert i ndërtimtarisë. Avokati i të paditurit theksoi që prova e paraqitur në raportin e ekspertit të ndërtimtarisë ishte në kundërshtim me “gjendjen reale për sa i përket sipërfaqes së objektit” si dhe me “gjetjet e ekspertit të gjeodezisë dhe situatës faktike në librat e kadastrës”. Avokati i të paditurit e kundërshtoi edhe ligjshmërinë e ndryshimeve në kërkesëpadinë e paditësit. Në fund të seancës kryesore, në të njëjtën ditë, gjykata nxori aktvendimin me të cilin e caktoi vlerën e kontestit të lëndës në atë shumë që e kishte kërkuar paditësi. Mirëpo, gjykata kurrë nuk i adresoi kundërshtimet e të paditurit, si dhe nuk i tregoi arsyet specifike përse këto argumente u refuzuan.

Në këtë lëndë, si dhe në shembullin para tij, gjykata dështoi t’i shqyrtojë në mënyrë të duhur kërkesat e palëve për të vendosur mbi çështjet që mund ta kishin përcaktuar rezultatin e procedurës që po zhvillohej. Në vend se t’i injorojnë vërejtjet, kërkesat dhe parashtrësat tjera përkatëse të palëve gjatë procedurës, gjykatat do të duhej t’ua demonstrojnë qartë palëve që vendimet e gjykatës nuk merren në mënyrë arbitrare. E vetmja mënyrë për ta bërë këtë është duke u përgjigjur gjithmonë me kohë në parashtrësat e palëve gjatë procedurës, si dhe duke nxjerrë aktvendime të arsyetuara mirë.

Përfundim dhe rekomandime

Zhvillimi i procedurës civile kontestimore në mënyrë të duhur është jetik për besimin publik ndaj profesionalizmit dhe korrektësisë së gjyqësorit. Palët në procedurën civile kontestimore kanë të drejtën që lënda e tyre të shqyrtohet në mënyrë të duhur, të drejtën për aktgjykim të arsyetuar, të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe të drejtën për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj. Në mënyrë që të garantohet respektimi i këtyre të drejtave, është esenciale që gjykatat t’i trajtojnë në mënyrë të duhur parashtrësat e palëve gjatë procedurës.

Në aktvendimet e dhëna më herët gjatë procedurës nuk është e domosdoshme të ofrohen arsyeime të gjata. OSBE-ja e ka theksuar edhe më herët brengën e saj rreth ngarkesës së madhe me lëndë dhe numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve në gjykatat e

²⁸ *Findlay kundër Finlandës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 21 janar 1997, paragrafi 73. Gjykatat gjithashtu e shkelin këtë të drejtë kur gjykata nuk është “subjektivisht e lirë nga paragjykimet e veta ose animi.” *Po aty*.

Kosovës, si dhe është e vetëdijshme për sfidat që paraqesin këto rrethana.²⁹ Megjithatë, në mënyrë që gjykatat të veprojnë në pajtim me kornizën ligjore të Kosovës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ato duhet t'i trajtojnë gjithmonë parashtresat e palëve gjatë procedurës me kohë, në pajtim me procedurat e parapara me ligj dhe me aktvendime të arsyetuara mirë.

Si përgjigje në çështjet e identifikuarat më lart, OSBE-ja rekomandon si në vijim:

- Gjykatat do të duhej të përgjigjen me kohë në parashtresat e palëve gjatë procedurës.
- Gjykatat do të duhej të përgjigjen në parashtresat e palëve gjatë procedurës me aktvendime të arsyetuara që i analizojnë faktet duke iu referuar kriterëve përkatëse ligjore.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës do të duhej të vazhdojë t'i trajtojë gjykatësit për të hartuar arsyetime dhe shkresa ligjore, me përqendrim të veçantë në hartimin e aktvendimeve dhe aktgjykimeve të arsyetuara në mënyrë të duhur.

²⁹ Shih raportin e OSBE-së “Numër i pamjaftueshëm i gjykatësve në Kosovë” (qershor, 2009), që gjendet këtu: http://www.osce.org/documents/mik/2009/09/39346_sq.pdf.